VENDIM
Nr. 454, datë 26.7.2023

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e", të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e ofruese publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP).

2. Hapja e një ofruesi publik të AFP-së është procesi i ngritjes dhe funksionimit për herë të parë të një shkolle të mesme profesionale, qendre shumëfunksionale të AFP-së apo qendre të formimit profesional.

3. Riorganizimi i një ofruesi publik të AFP-së është procesi i bashkimit me një ose disa ofrues të AFP-së, ndarja në më shumë se një institucion, zgjerimi apo zvogëlimi i objektit të veprimtarisë apo të ofertës së kualifikimeve profesionale.

4. Mbyllja e një ofruesi publik të AFP-së është procesi i mbarimit të funksionimit të një ofruesi të AFP-së.

II. HAPJA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE, OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

1. Nisma për hapjen e ofruesit publik të arsimit dhe formimit profesional merret nga:

a) ministria përgjegjëse për AFP-në;

b) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) partnerët socialë, përfaqësuesit e komunitetit të biznesit;

ç) institucione të tjera publike, përgjegjëse për zhvillimin e politikave, sektoriale dhe lokale ose të përfaqësuesve të grupeve të tjera të interesit.

2. Propozimi për hapjen e një ofruesi publik të AFP-së, kur është nismë e parashikuar në shkronjat "b", "c", "ç", të pikës 1, të këtij vendimi, shoqërohet me këto dokumente:

a) Argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së ofruesit publik të AFP-së, bazuar në analizën e tregut rajonal të punës;

b) Të dhëna për kontributin e njësisë së vetëqeverisjes vendore;

c) Të dhëna për kontributin e biznesit/partnerëve socialë, ku pritet të hapet institucioni arsimor;

ç) Të dhëna për përmbushjen e kritereve, të parashikuara në kreun III, pika 1, të këtij vendimi;

d) Kostot financiare dhe burimet njerëzore që parashikohen për hapjen e ofruesit të AFP-së.

3. Propozimi për hapjen ofruesit publik të arsimit profesional, shkollë e mesme profesionale, si dhe qendër shumëfunksionale, paraqitet pranë ministrisë përgjegjëse për AFP-në, të paktën, një vit përpara fillimit të vitit shkollor në rastin kur kërkohet ndërtesë e re dhe 3 (tre) muaj në rastin kur ka godinë.

4. Propozimi për hapjen e ofruesit publik, qendër formimi profesional, paraqitet pranë ministrisë përgjegjëse për AFP-në, në çdo kohë.

5. Propozimi për hapjen e një ofruesi publik të AFP-së, kur është vendimmarrje e ministrisë përgjegjëse për AFP-në, bëhet:

a) në bazë të kërkesës së tregut të punës;

b) kur ndryshojnë kushtet dhe kualifikimi për kategori të caktuara aftësish;

c) në rastin e investimeve të reja dhe/apo teknologjive të reja, që kërkojnë aftësi të reja.

6. Ministria përgjegjëse për AFP-në shqyrton propozimin e dërguar për hapjen e ofruesit publik të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet strukturave përgjegjëse për arsimin dhe

formimin profesional, si dhe konsultohet me palën propozuese dhe grupet e interesit, brenda një afati tremujor.

7. Njësia përgjegjëse për AFP-në, pas shqyrtimit të kërkesës, njofton kërkuesin me shkresë zyrtare për pranimin apo refuzimin e saj.

III. KRITERET PËR HAPJEN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE OFRUES TË AFP-së

1. Për hapjen e ofruesve publikë të AFP-së duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) Ndërtesa dhe mjediset e saj plotësojnë kushtet për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

b) Ndërtesa e shkollës/qendrës, reparteve të praktikës profesionale dhe mjediset e saj plotësojnë standardet, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Sigurohen, sipas legjislacionit në fuqi, këto shërbime:

i. furnizim me ujë;

ii. ngrohje;

iii. furnizim me energji elektrike.

ç) Të kenë infrastrukturë didaktike e përshtatshme që plotëson standardet, sipas legjislacionit në fuqi;

d) Standardet që lidhen me kurrikulën mësimore të arsimit dhe formimit profesional dhe standardet e kurrikulës mësimore të arsimit të përgjithshëm, që u ofrohet nxënësve në institucionet publike që ofrojnë arsim të mesëm profesional rregullohen sipas legjislacionit në fuqi, të miratuara nga ministritë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të tyre;

dh) Numri i nxënësve/kursantëve për klasë është sipas akteve nënligjore të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për AFP-në;

e) Ngarkesa mësimore e mësuesve është sipas standardeve të përgjithshme të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për AFP-në dhe ministria përgjegjëse për arsimin.

IV. RIORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE, OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

1. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, riorganizohen:

a) për shkak të përmbushjes së disa qëllimeve ose shtimit të disa qëllimeve të tjera në fushën e kualifikimeve profesionale, sipas niveleve 2–5, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

b) kur lind nevoja e bashkimit të dy a më shumë institucioneve ofruese të AFP-së për rritjen e frytshmërisë së përdorimit të infrastrukturës së tyre;

c) kur lind nevoja e ofrimit të kualifikimeve të reja apo mbylljes së kualifikimeve të ofruara nga një ofrues;

d) për të optimizuar burimet njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës;

dh) me kërkesë të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në bazë të studimeve të argumentuara;

e) në bazë të kërkesës së banorëve të zonës ku ushtrojnë veprimtarinë, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe me struktura të reformuara;

f) kur vlerësohet nevoja për transferim në një zonë tjetër për ushtrimin e veprimtarisë;

g) në çdo rast tjetër, në kuadër të zbatimit të reformave në fushën e politikave punësimit dhe të arsimit dhe formimit profesional.

2. Vendimmarrja e ministrisë përgjegjëse për AFP-në për riorganizimin bazohet në vlerësimet e nevojave për kualifikime profesionale të kryera nga institucionet përgjegjëse në varësi të saj, bazuar në analizën e kushteve social-ekonomike të zonës ku do të ndodhë riorganizimi, performancën e tregut të punës, situatën aktuale dhe prirjet në punësim, sipas profesioneve dhe sektorëve ekonomikë, si dhe në bazë të vlerësimit të performancës dhe të plotësimit të standardeve nga ofruesit ekzistues të AFP-së.

3. Bordet dhe drejtuesit e institucioneve ofruese të AFP-së, njësitë e vetëqeverisjes vendore, partnerët socialë, përfaqësuesit e biznesit të zonës, si dhe përfaqësues të grupeve të tjera të interesit luajnë rol këshillimor në procesin e vlerësimit të nevojës për riorganizim.

4. Riorganizimi për institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional fillon në përfundim të vitit shkollor.

V. MBYLLJA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE, OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

1. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, mbyllen kur:

a) kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë krijuar ose nuk e përmbushin atë;

b) nuk sigurojnë ofertë të përshtatshme për kërkesat e tregut të punës;

c) frekuentimi/regjistrimet është/janë i ulët/të ulëta (në rënie) për tri vite radhazi dhe nuk justifikon mbajtjen e tyre.

2. Në çdo rast, ministria përgjegjëse për AFP-në bën konsultime me drejtuesit dhe bordin e institucionit, ofruesit e arsimit dhe formimit profesional, njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, banorët dhe partnerët socialë.

3. Mbyllja për institucionet publike, ofruese të arsimit profesional, i fillon efektet në përfundim të vitit shkollor, ndërsa për institucionet e formimit profesional, efektet fillojnë me mbylljen e vitit buxhetor.

4. Në urdhrin e mbylljes së institucionit publik, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, parashikohen edhe trajtimi i punonjësve që dalin të papunë, trajtimi i nxënësve/kursantëve, arkivimi i dokumentacionit të institucionit dhe destinacioni i mjeteve monetare e materiale, në përfundim të likuidimit përkatës.

5. Në rastin e mbylljes së një institucioni publik, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, ministri përgjegjës për AFP-në, ngre një komision të posaçëm, i cili monitoron gjithë procesin e mbylljes, në përputhje me urdhrin përkatës, si dhe ankimimet që mund të mbërrijnë nga palët e interesuara.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 198, datë 4.3.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e krijimit, riorganizimit dhe mbylljes së institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional", shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit e arsimit dhe formimit profesional për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku